

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me:	18.05.2023	
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtet, pa Dopetar
15-052/01-25678		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Lipjan, me 18.05.2023

PËR:	z.Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës Lipjan
Nga	Nexhmedin Lekiqi, Kryesues i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale <i>Nexhmedin Lekiqi</i>
LËNDA :	Raporti i Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

I nderuar Kryesues, përmes kësaj shkrese po ju dorëzojme Raportin e Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe kërkojmë nga ana e juaj që të njejtin ta procedoni si pikë të rendit të ditës për mbledhjen e ardhëshme të Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Ju faleminderit!

KOMUNA E LIPJANIT

Më 18.05.2023

RAPORT I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Në bazë të nenit 32 dhe 36 të Statutit të Komunës, me Vendim të Kuvendit të Komunës të datës 31.01.2022 është themeluar Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (KSHPS).

Detyrat themelore të KSHPS:

- Monitorimi i shërbimeve për kujdesin primar në komunën e Lipjanit;
- Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me mbrojtjen e kategorive të caktuara shoqërore dhe sociale;
- Zhvillimi i konsultimeve dhe përkrahjes e Drejtorisë për shëndetësi dhe përkrahje sociale; etj.

KSHPS përbëhet nga anëtarët e Kuvendit:

Nexhmi Lekiqi – kryesues;
Gazmend Qerkini – anëtar;
Fitim Mëziu – anëtar;
Ganimete Qeriqi- anëtare; dhe
Shefki Bytyqi – anëtar.

Fushëveprimi kohor i raportimit dhe përmbajtja:

Me këtë Raport përfshihet periudha e punës së KSHPS nga periudha e themelimit e deri me datën 15 maj 2023.

Në kuadër të përmbajtjes së këtij Raporti përfshihet:

- Aktivitetet e Komitetit në kuadër të takimeve të rregullta të punës.
- Vizitat e punës në Qendrat e Mjekësisë Familjare.
- Vizitë pune në Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare.
- Vizitë pune në shoqatën “Handikos” në Lipjan.

I. Brenda periudhes raportuese, KSHPS ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje pune. Në mbledhje kanë prezantuar të gjithë anëtarët e Komitetit dhe po ashtu në shumicën e mbledhjeve ka qenë i ftuar dhe ka prezantuar Drejtori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale z. Shkelzen Hajdini.

Në mbledhjet e mbajtura, Komiteti është informuar nga afër për ecuritë, sfidat dhe projektet e planifikuara dhe ato të realizuara, të cilat i ka pasur në planin e punës Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Anëtarët e Komitetit në veçanti kanë shfaqur interesim, kanë bërë pyetje dhe kanë dhënë sugjerimet/rekomandimet e tyre lidhur me problemet e tanishme në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, si dhe për projektet zhvillimore për të ardhmen.

Komiteti ka diskutuar dhe përkrahur në tërësi Planin e veprimit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale të propozuar nga Drejtori i shëndetësisë dhe i plotësuar nga anëtarët e Kuvendit.

Propozimi i Komitetit ishte edhe shqyrtimi i mundësisë për stimulimin e mjekëve dhe stafit tjetër në vendet rurale jashtë QKMF-së, pastaj të bëhet shpërndarja e detyrave dhe përgjegjësisë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë ndërmjet punonjësve, të shtohen angazhimet e ekipit për shërbimet paliative në terren etj.

II. KSHPS me datën 14 shkurt 2023 ka organizuar vizita në të gjitha QMF-të e komunës sonë me përjashtim të QMF-së në Gadime, ku objekti është në renovim e sipër. Mirëpo në javën e parë të muajit maj 2023 është funksionalizuar QMF në Gadime – e cila tani teknikisht ofron kushte të jashtëzakonshme për shërbime mjekësore kualitative në këtë lokalitet.

Në këto vizita, anëtarët e Komitetit kanë dëgjuar me vëmendje të gjitha ankesat dhe propozimet e punonjësve të QMF-ve. Si konkluzion i përbashkët nga këto takime, kanë rrjedhë:

- Barnat nga lista esenciale nuk janë të mjaftueshme për tërë muajin;
- Ka mungesë të gjeneratorëve për rrymë pasi QMF punojnë deri në orën 19:00;
- Në disa QMF mungojnë lavatriqet;
- Në disa QMF rryma elektrike është e dobët dhe për këtë shkak nuk funksionojnë aparaturat mjekësore;
- Në disa QMF mungon nxemja e nivelit të duhur dhe ka nevojë për ndërrimin/riparimin e pajisjeve;
- Në QMF në Janjevë përveç vështirësive të cekura është e dëmtuar edhe dyshemeja.

Po ashtu mirëmbajtësit e objekteve janë ankuar se nuk kanë mjete për kositje dhe mirëmbajtje të oborreve të QMF-ve,

KSHPS, po ashtu vlerëson si një sfidë të veçantë shkuarjen në terren të ekipeve mjekësore për konfirmuar vdekjet që ndodhin në shtëpi. Lidhur me këto, familjarët kërkojnë udhëzime më të qarta.

Në QMF në Magure është i theksuar problemi me ofrimin e shërbimeve mjekësore për azilkërkuesit.

Në QMF në Kraishtë, vlerësojmë se duhet ndryshuar hyrja e pacientëve në oborrin e objektit për shkak të terrenit të papërshtatshëm.

Gjatë vizitave në terren, përveç tjerash anëtarët e KSHPS gjeten edhe shumë çështje që ishin në nivel të duhur, siç është gatishmëria profesionale e stafit për ofrimin e shërbimeve mjekësore, duke përfshirë ato stomatologjike, laboratore funksionale dhe me shërbime (analiza) pothuaj sikurse në QKMF, pastaj kryerja e renovimeve në disa objekte të QMF-ve etj.

III. KSHPS në përbërje të plotë, në pjesën e dytë të muajit prill 2023 ka pasur një vizitë pune në Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Lipjan. Në këtë rast Komisioni u takua me menaxhmentin e QKMF-së dhe me Drejtorin e Departamentit për shëndetësi dhe përkrahje sociale.

Qëllimi i kësaj vizite ishte të shihen nga afër zhvillimet dhe sfidat që po e përcjellin këtë institucion shëndetësor duke pasur parasysh veçanërisht:

- Shërbimet mjekësore në QKMF- sidomos organizimin e shërbimeve të mjekësisë familjare;
- Shërbimet urgjente;
- Maternitetin; dhe
- Shërbimet paliative.

1. Komiteti u njoftua nga menaxhmenti me të arriturat e fundit dhe synimet për të ardhmen lidhur me organizimin e shëndetësisë në nivel komunal, veçanërisht me zhvillimin e mjekësisë familjare duke pasur parasysh specifikisht formën e ofrimit të shërbimeve nga mjeku familjar sipas parimit një mjek një pacient.

Anëtarët e Komitetit vlerësojnë se në QKMF në Lipjan ka përparime të theksuara viteve të fundit, duke filluar nga higjiena, renovimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të punës së personelit shëndetësor. Përparime të theksuara janë shënuar edhe në infrastrukturën e diagnostifikimit siç është ultrazëri, rendgeni dhe laboratorit.

Komiteti po ashtu u njoftua se QKMF në Lipjan është pjesëmarrëse në disa pilot projekte, siç është përkujdesja për të sëmuarit kronik, përkujdesja për shtatëzënat dhe lehonat, si dhe telemjekësia.

Si të arritura në vitet e fundit duhet veçuar rritjen e numrit të analizave laboratorike, pajisjen me aparaturë moderne dhe fuqizimin e shërbimeve stomatologjike.

Rekomandimet:

- Të kthehet sistemi i mjekësisë familjare një mjek një pacient;
- Të evidentohen të gjithë personat me nevoja të veçanta, me qëllim që të dihet numri i tyre dhe për ta të ofrohet ndihma e nevojshme dhe e mundshme.

2. Anëtarët e Komitetit e vizituan objektin e QKMF-së dhe interesim të veçantë patën sidomos për hapësirën e urgjencës, për shërbimet që ofrohen dhe për sfidat të cilat e përcjellin këtë shërbim.

Anëtarët e Komitetit nga ajo që panë dhe informacionet e marra nga menaxhmenti gjatë diskutimeve të zhvilluara, vlerësojnë se objekti i destinuar për shërbime të urgjencës nuk ofron kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve urgjente. Po ashtu shërbimet e ofruara e tejkalojnë qëllimin e shërbimeve urgjente dhe kjo ndikon që ky shërbim të jetë i ngarkuar tejmasë.

Lidhur me këte u dhanë disa rekomdime si:

- Të ofrohet shërbimi i triazhit;
- Është tepër e nevojshme që të sigurohet hapësirë shtesë për shërbimet e urgjencës në kuadër të hapësirave të tjera të objektit të QKMF-së, duke pasur parasysh faktin se deri te ndërtimi dhe kompletimi i objektit të ri të QKMF-së do të duhet kohë (2-3 vite); dhe
- Të angazhohet shërbimi i sigurimit gjatë ndërrimit të natës.

3. Nga diskutimet e zhvilluara me menaxhmentin, por edhe me disa punonjës të QKMF-së u informuam se ka mjaft vërejtje për shërbimet e maternitetit. Këto shërbime nuk kanë kosto efektive dhe po ashtu aspak nuk janë produktive. Në vitin 2022 vetëm katër lindje janë kryer në këtë shërbim.

Po ashtu nëkuadër të maternitetit nuk i kushtohet rëndësi shërbimeve profesionale këshilldhënëse për grupet prenatale dhe postnatale.

Rekomandime:

- QKMF të ofroj vetëm kontrollet gjinekologjike.
- Të ofrohen shërbime për edukimin e prindërve të rinjë.

4. Anëtarët e KSHPS u informuan lidhur me ofrimin e shërbimeve aktuale paliative nga QKMF dhe lidhur me këte vlerësohet se ky shërbim është mjaft i mangët si në cilësi ashtu edhe në kuantitet. Këto shërbime ofrohen pesë ditë në javë dhe vetëm gjatë një ndërrimi në ditë, kurse nevojat janë shumë më të mëdha se sa ato që ofrohen. Po ashtu nga ajo që kemi trajtuar lidhur me këto shërbime vërehet se popullata nuk është e njoftuar mjaftueshëm për këto shërbime.

Rekomandim:

Ky shërbim duhet fuqizuar si në aspektin kadrovik po ashtu edhe në ate teknik.

Shënim:

Anëtarët e KSHPS janë të njoftuar me planet për zhvillimin e infrastrukturës për QKMF, përkatësisht për ndërtimin e objektit të ri në Lipjan, prandaj është e kuptueshme që investimet eventuale të tanishme në vlera të mëdha në infrastrukturën e tanishme të QKMF-së nuk do të jenë të qëndrueshme. Prandaj vetëm disa disa nga nevojat më të domosdoshme duhet plotësuar deri në ndërtimin e objektit të ri.

IV. Në cilësinë e Kryesuesit të KSHPS kemi vizituar zyrën e shoqatës “Hendikos” në Lipjan, anëtarë të së cilës janë personat me nevoja të veçanta. Në këtë rast biseduam me Kryetarin e shoqatës, nga i cili u njoftova me punën e shoqatës, sfidat me të cilat përballen në punën e përditshme, për mbështetjen që iu ofrohet nga organet komunale, për nevojat e tanishme, si dhe për planet afatmesme.

Kryetari i shoqatës theksoi se Lipjani është një nga qytetet në të cilin aksesibiliteti në institucionet shtetërore/publike është i kënaqshëm duke përfshirë edhe vendkalimet në trafik. Por në disa nga objektet private megjithë përpjekjet për të përshtatur aksesibilitetin në disa nga to ka vështirësi për qasje më të lehtë të këtyre kategorive të personave.

Kryetari i shoqatës po ashtu theksoi se me organet komunale ka kontakte të vazhdueshme, duke përfshirë edhe Drejtoratin për shëndetësi dhe përkrahje sociale. Kohë pas kohe shoqatës i ofrohet ndihmë financiare afatshkurtër me qëllim të organizimit të shetitjeve ditore për anëtarët e saj. Por ai kërkoi që të bëhen përpjekje për të inicuar mundësinë e ofrimit të ndihmës për anëtarët e shoqatës në aspektin e trajtimeve dhe rehabilitimeve në qendrat rehabilituese dhe në banjë.

Gjithashtu ai theksoi se një ndihmë e tillë është jashtëzakonisht e nevojshme dhe është kërkesë përmanente e anëtarëve e shoqatës.

Kryetari u shprehë se nuk kanë problem lidhur me furnizimin me mjete ndihmëse për levizje dhe mjete të tjera ortopedike për nevoja të anëtarëve.

Një nga problemet themelore në shoqatë sipas Kryetarit janë kushtet e tanishme të zyrës së shoqatës, të cilat nuk i plotësojnë nevojat e anëtarëve, sidomos nyja sanitare. Një gjendje e tillë u pa edhe nga vizita e zhvilluar në objekt.

Rekomandim:

Komiteti rekomandon DSHPS dhe organet tjera kompetente që të shqyrtojnë mundësinë e ofrimit të përkrahjes financiare të anëtarëve për nevoja rehabilituese dhe trajtime në banjë si dhe për zgjidhjen e problemeve hapësoinore të zyreve të shoqatës.

Përfundim:

Anëtarët e KSHPS – unanimisht janë të pajtimit se në komunën e Lipjanit ka përparim të dukshëm në infrastrukturën teknike dhe në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

Anëtarët e KSHPS do të vazhdojnë të përcjellin nga afër të gjitha zhvillimet dhe do të qëndrojnë pranë DSHPS-së për t'i ofruar sugjerimet tona për përmirësimet dhe avancimet e mëtutjeshshme të kushteve dhe shërbimeve.

Anëtarët e KSHPS nuk do të hezitojnë t'i shohin të gjitha përparimet që po bëhen, por njëkohësisht do t'i sjellim para jush edhe ngecjet e mundshme konform me obligimet dhe autorizimet tona që rrjedhin nga Kuvendi i Komunës.

Ky Raport u hartua nga Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Në emër të Komitetit:

Dr. Nexhmedin Lekiqi – Kryesues

